



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2018:007050

Datë: 06.10.2020

Numri i dokumentit: 01166402

PKR.nr.32/2020

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN – Departamenti për krime të rënda, divizioni penal, si gjykatë penale e shkallës parë, në trupin gjykues të përbërë prej : Aziz Shaqirit – kryetar i trupit gjykues, Naser Maliqi dhe Islam Thaçi – anëtarë të trupit gjykues, në lëndën penale kundër të akuzuarit E.B, Komuna e Gjilanit, për shkak të veprës penale falsifikimi i dokumentit zyrtar nga neni 434 paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtutjeshëm KPRK-s), të cilin sipas autorizimit e mbron av. Sevdail Robelli nga Gjilani, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan – Departamenti për krime të rënda PP.I.nr. 63/2018 të datës 27.03 të vitit 2018, të cilën e përfaqësoi prokurori i shtetit Shaban Spahiu, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe publik më datën 18 shtator të vitit 2020, nxjerr kurse kryetari i trupit gjykues në prani të palëve dhe mbrojtësit të të akuzuarit në të njëjtën ditë publikisht shpalli këtë,

A K T G J Y K I M

I. I akuzuari E. B nga babai M. dhe nëna N. – me mbiemër të vajzërisë R., i lindur më datën..., Komuna e Gjilanit, ku edhe tani e ka vendbanimin, posedues i telefonit mobil me SIM karte , shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar, baba i dy fëmijëve të mitur, ka të kryer shkollën e mesme, zyrtar policer në Stacionin Policor në Gjilan, me gjendje të mesme ekonomike, i pagjykuar dhe nuk zhvillohet procedure tjetër penale ndaj tij, i tërhiqet vërejtja se është i detyruar që ta lajmëroj gjykatën për çdo ndërrim eventual të vendbanimit përkatësisht të vendqëndrimit të tij nën kërcënim të pasojave ligjore,

Ë s h t ë f a j t o r

sepse me datën 08.01 2018 në Stacionin Policor në Gjilan, ka flsifikuar dokumentin zyrtar në atë mënyrë që ka ndryshuar në tiketën – fletëparaqitjen për kundërvajtje në trafik të paraqitur nga zyrtari policor me numër 258386 më datën 08.01.2018, përkitazi me një kundërvajtje ndaj kundërvajtësit A.H, duke shënuar me laps kimik në vend të nenit 188 nenin 118 sipas të cilit nen parashihet dënimi kundërvajtës me gjobë më të vogël dhe për pasojë të këtij përmirësimi kundërvajtësi në fjalë në vend që të paguaj dënimin me gjobë që ka qenë i paraparë prej 100 deri në 300 Euro, ka paguar 10 Euro përkatësisht 50% të gjobës të paraparë prej 20 Euro sipas nenit të shënuar me dorëshkrim nga i akuzuari,

- me çka ka kryer veprën penale **falsifikimi i dokumentit zyrtar** nga neni 434 paragrafi 1 të KPRK-s.

Gjykata, në bazë të dispozitave të cituara, nenit 4, 7, 21, 41, 45, 46, 47, 73, 74 dhe 75 të KPRK-s si dhe nenit 365 të Kodit të Procedurës Penale (KPP-s) të akuzuarin në fjalë,

E GJYKON

me dënim me burgim në kohëzgjatje prej njëqindetëdhjetë (180) ditëve, i cili pas shpalljes së këtij aktgjykimi me pëlqimin shprehimisht të dhënë nga i akuzuari, në kuptim të nenit 47 të KPRK-s

I ZËVENDËSOHET me dënim me gjobë në shumën prej njëmijëedyqind (1,200.00) Euro, të cilin duhet ta paguaj në gjashtë këste të barabarta prej nga 200 Euro në muaj, duke filluar nga dita pasuese e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi,

mirëpo nëse i pandehuri nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj dënimin me gjobë, në kuptim të nenit 46 paragrafi 3 të KPRK-s i njëjti **I ZËVENDËSOHET me dënim me burgim** duke ju llogaritur çdo 20 Euro të gjobës me një ditë burgim, përkatësisht **në kohëzgjatje prej gjashtëdhjetë (60) ditëve**, të cilin duhet të filloj ta mbaj në afat prej 15 ditëve pas marrjes së ftesës nga ana e kësaj gjykate, nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

IV. DETYROHET i pandehuri në fjalë që kësaj gjykate t'ia paguaj shpenzimet e procedurës penale përkitazi me paushallin gjyqësor në shumën prej **tridhjetë (30) Euro**, si dhe taksën për kompensimin e viktimave të krimit në shumën prej **50 Euro**, të gjitha në afat prej 15 ditëve, nga dita pasuese e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

1. Hyrje në arsyetim

Prokuroria Themelore në Gjilan – DKR kundër të akuzuarit në fjalë ka paraqitur aktakuzën lëndore, për shkak të dyshimit të bazuar mirë se i njëjti ka kryer veprën penale nga neni 434 paragrafi 1 të KPRK-s, për të cilën parashihet dënimi me burgim prej gjashtë muaj deri në pesë vjet.

Kryetari i trupit gjykues duke vepruar sipas aktvendimit të Gjykatës së Apelit me vërejtjet e dhëna ka caktuar seancën e shqyrtimit gjyqësor duke formuar trupin gjykues, e pastaj me ftesa të veçanta ka ftuar palët dhe pjesëmarrësit tjerë sipas aktakuzës lëndore,

Gjatë shqyrtimit gjyqësor pas leximit të dispozitivit të aktit akuzues nga ana e prokurorit të shtetit, i akuzuari ka deklaruar se e ka kuptuar akuzën në tërësi mirëpo nuk e pranon fajësinë për veprën penale me arsyetim se të njëjtën nuk e ka kryer ashtu siç akuzohet.

Pas administrimit të provave dhe dëgjimit të të akuzuarit palët kanë dhënë fjalët përfundimtare si në vijim :

Prokurori i shtetit Shaban Spahiu gjatë fjalës përfundimtare ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë akuzës kundër të akuzuarit në fjalë, meqë si nga provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor në mënyrë të plotë dhe të qartë është vërtetuar gjendja faktike lidhur me këtë çështje

penale, nga e cila rezulton se i akuzuari ka kryer veprën penale nga neni 434 paragrafi 1 të KPRK-s sipas dispozitivit të aktit akuzues, duke i propozuar gjykatës që të njëjtin ta shpall fajtor dhe dënoj sipas Kodit Penal.

Mbrojtësi i të akuzuarit av. Sevdail Robelli ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë fjalës përfundimtare të paraqitur me shkrim pa ndryshime dhe plotësime. Në fjalën përfundimtare ndër të tjera ka theksuar se në rastin konkret përgjegjësia penale si element subjektiv i veprës penale perkitazi me të mbrojturin e tij nuk është vërtetuar, pasi që në rastin konkret i mbrojturi i tij ka vepruar në lajthim faktik përkatësisht juridik duke e interpretuar përgjigjen e dëshmitarit S. se i njëjti kishte dhënë miratim për të bërë ndryshimin me të vetmin qëllim që t'i ndihmohet një të dëmtuari i cili ka pas gjendje të rëndë ekonomike dhe se gjatë luftës së fundit në Kosovë ka humbur 7 anëtarë të familjes, kështu që me kamionetën e tij ka siguruar ekzistencën ekonomike të familjës së tij dhe se marrja e patent shoferit kishte me ia vështërsu me të madhe mundësinë për të siguruar ekzistencën e familjes së të dëmtuarit. Në mungesë të elementit subjektiv ka konsideruar se nuk janë përmbush të gjitha tiparet e veprës penale lëndore andaj ka propozuar që të mbrojturin e tij gjykata ta liroj nga pergjegjesia penale.

I akuzuari ka deklaruar se tiketa e ndryshuar lëndore është proceduar sikurse të gjitha tiketat tjera, prandaj edhe e mbështetë deklaratën e mbrojtësit të tij.

2. Provat e administruara

Trupi gjykues ka administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor provat personale me dëgjimin e dëshmitarëve si në vijim :

- S. D – zyrtar policor në Stacion Policor në Gjilan, deklarata e të cilit është konsideruar si e lexuar me pëlqimin e palëve meqë i njëjti nuk e ka arsyetuar mungesën e tij edhe pse është ftuar me rregull dhe
- A. I, Komuna e Gjilanit, i cili ka mbetur në tërësi pranë deklaratës së dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor paraprak pa ndryshime dhe plotësime.

si dhe

provat materiale duke u konsideruar si të lexuara si në vijim :

-raportin përkatësisht raportet e oficerve policor,

-fletëparaqitjen e kundërvajtjes në trafik kundër të pandehurit A. I me numër 2583386 të datës 08.01 2018 dhe

-fletëpagesës së dënimit për kundërvajtje në shumën prej 10 Eurove të datës 16.01 2018 por edhe me dëgjimin e mbrojtjes së të akuzuarit në fjalë,

Trupi gjykues pas shqyrtimit detal dhe me vëmendje si dhe përkushtim maksimal profesional të mbrojtjes së të akuzuarit, por edhe të provave të administruara personale dhe materiale, edhe atë secilën veç e veç dhe të lidhura mes vete ka vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë gjendjen faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke e shpallur fajtor të akuzuarin për veprën penale lëndore me arsyetim të plotë në vijim të këtij arsyetimi të aktgjykimit.

3. Mbrojtja e të akuzuarit

I akuzuari E.B mbrojtjen e tij ka deklaruar se që 17 vite është zyrtar policor në Policinë e Kosovës, ndërsa si zyrtar për arhiv në kuadër të Stacionit Policor në Gjilan punon prej vitit 2014 e gjer më tani.

Në pytjen e mbrojtësit lidhur me zhvillimin e takimit të dëshmitarit A. I me ju si i akuzuar dhe veprimet e ndërmara, i akuzuari është përgjigjur: dëshmitari A.I ni siç e ka njoftuar vajza e tij tek shtëpia e tij ka qenë dy apo tri herë, e që me te nuk është takuar pasi që ka qenë në punë, kurse herën e katërtë kur është kthyer nga puna me të njëjtin është takuar para shtëpisë së tij dhe i njëjti i ka treguar se ja kanë shqiptuar një tiketë duke ja konfiskuar edhe patent shoferin ,duke ju lutur shumë bile duke qajtur me arsyetim se pa patent shofer nuk mund ta ushtroj veprimtarinë e tij si mbledhës i mbeturinave pasiqë të njëjtat i bart me kamionetë. Pasiqë e ka kry bisedën me te, të njëjtit i ka thënë se nuk di çka të them për te, mirëpo nëse ka diçka, pra nëse mundet t'i ndihmoj do ta njoftoj. Më tutje ka shtuar se policin S.D e ka takuar në koridor të Stacionit Policor në Gjilan dhe ka kërkuar nga ai përgjigje se a mundemi t'i ndihmojmë personit të cilit ia keni shqiptuar një dënim për kundërvajtje duke i dhënë shpjegime se kemi të bëjmë me një person i cili ka gjendje të rëndë ekonomike dhe se i njëjti si bashkëfshatar ka qenë tek ai dhe i është lutur për ndihmë. S. i është përgjigjur se **“unë tiketën e shqiptuar e kam dorëzuar, mirëpo nëse ekziston ndonjë mundësi që muni me përmirësu unë jam dakord dhe mua nuk më prish punë nëse dispozita ndërrohet në atë tiketë”**. I akuzuari është betuar se këtë që po e thotë tani është e vërtetë qind për qind duke aluduar në atë që ia ka thënë dëshmitari S. dhe se i njëjti nuk e ka thënë të vërtetën pasiqë ju ka tut përgjegjësisë. I akuzuari këtë përgjigje të S. e ka kuptu si aprovim ma shumë për po se përndryshe nuk do të kishte vepruar ashtu siç ka vepruar, kështu që e ka ndërru vetëm nenin në tiketë tue ditë gjendjen shumë të rëndë ekonomike të dëshmitarit në fjalë i cili edhe i ka të humbur 7 anëtarë të familjes gjatë luftës nga serbët. Më tutje ka deklaruar se mund ta njoftoj gjykatën edhe për këtë se para një jave policia e ka dënuar babain tij e ky as që ka tentuar që tiketën e tij ta përmirësoj apo ta hjek, pastaj se ka pas edhe anëtarë tjerë të familjes që e kanë pas rastin e ngjashëm por asnjë veprim nuk e ka ndërmarr lidhur me të njëjtit. E ka njoftuar gjykatën se gjatë intervalit kohor sa ka punuar në polici asnjëherë nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim të tillë dhe kjo se është hera e parë e këtë veprim e ka ndërmarrë vetëm e vetëm për shkak të gjendjes ekonomike të rëndë të personit në fjalë duke shtuar edhe arsyen e cekur më lartë. Duke e ditë gjendjen jo të mirë ekonomike të këtij personi edhe pas ndërrimit të dispozitës ligjore në tiketë e ka paguar tiketën vet por kuptohet me çmim më të lirë. Kur ka kërkuar A.I ndihmë nga ai nuk i ka premtuar asgjë si shpërblim për ndihmën e dhënë, por as i akuzuari nga ai nuk ka kërkuar kurfarë shpërblimi dhe kurfarë dobie. I akuzuari është ankuar se ka probleme me këmbë meqë vuan prej trombozës andaj edhe nuk mund të qëndroj në këmbë.

Në pytjen e prokurorit të shtetit i akuzuari ka deklaruar se nuk i kujtohet neni i cili është ndërruar në tiketë saktësisht por kundërvajtja i kujtohet ashtu siç e ka përshkruar dëshmitari A.I. Është e vërtetë se e ka paguar 50% të vlerës së kundërvajtjes prej shumës 20 eurove për kundërvajtje më të volitshme të gjobës.

Në pytjen e prokurorit të shtetit se ju këtë që e thatë në këtë seancë përkita me atë që ju ka thënë dëshmitari S.D kur ju e keni pyt për t'i ndihmuar personit të cilit i ka shqiptuar një tiketë, e këtë nuk e keni përmend as para inspektoratit e as në prokurori, atëherë cila është e vërteta, i akuzuari është përgjigjur se e vërteta është ajo që tha sot dhe qind për qind është i sigurt dhe se i ka mbetë në kujtesë se çka i ka thënë S. din saktë lokacionin ku e ka taku dhe i njëjti i ka thënë **“nëse ka mundësi me bo diçka mua nuk më pengon dhe unë nuk do të ankona”**, e këtë i akuzuari e ka kuptuar si miratim, siç ka thënë edhe në mbrojtjen e tij.

Po ashtu ka shtuar edhe këtë, se të njëjtën deklaratë e ka thënë edhe në Inspektorat.

Më tutje i akuzuari ka deklaruar se sa i përket ndërrimit të nenit në tiketë **është nis prej asaj pikëpamje se nuk është duke e shkel ligjin pasi që një veprim të tillë e ka ndërmarrë me aprovim të kolegut të tij S.D.**

Në pyetjen e kryetarit të trupit gjykues i akuzuari përgjigjet : këtë veprim për të cilin akuzohem ekskluzivisht e kam ndërmarrë për shkak të gjendjes së rëndë ekonomike të bashkëfshatarit tim pa kurrëfarë përfitimi, shpërblimi apo dobie, por edhe duke pas parasysh faktin se ky person gjatë luftës ka humbur 7 anëtarë të familjes dhe tani e mbanë familjen vetëm me grumbullim të mbeturinave të hekurit dhe jeton nga ndihma që ia ofrojnë bashkëfshatarët, por edhe arsyen të cilën e ka thënë më herët. Më tutje i akuzuari shton edhe këtë se kur kam intervenu në dokument zyrtar për arsyet e lartëcekura nuk kam llogaritur se do të përgjigjem penalisht.

4. Deklaratat e dëshmitarëve

a) Deklarata e dëshmitarit S. D - i cili nuk është në farefisni as me të akuzuarin e as me dëshmitarin tjetër – e i cili ka deklaruar si në vijim lidhur me çështjen konkrete penale :

Në pyetjen e prokurorit të shtetit dëshmitari përgjigjet se e mbështetë deklaratën e dhënë në prokurori lidhur me këtë çështje penale dhe se si zyrtar policor në Njësitin Reagues punon në Stacionin Policor në Gjilan. Se fillimisht nuk ka qenë në dijeni për intervenim në një tiketë kundërvajtëse në trafik të cilën e ka përpiluar gjatë orarit të punës përkitazi me një rast. Se kundër kujt e ka paraqit atë tiketë vërtetë është një kohë e gjatë dhe vërtetë nuk mund të deklarohet se gjatë orarit të punës ka pas edhe detyra tjera. Pas një kohe, koha e saktë nuk i kujtohet, është njoftuar prej shefit të Operativës në kuadër të Stacionit Policor në Gjilan se kanë has në një ndryshim në një tiketë që ky e ka shqiptu ma herët. Sipas njoftimit që ia ka dhënë i njëjti - ky ndryshim ka konsistuar në dispozitën kundërvajtëse por edhe shumë e gjobës së paraparë me dispozitën përkatëse. Neni tani nuk i kujtohet por edhe emri i individit që ia ka shqiptu tiketën, mirëpo e di se personi i tillë ka qenë në ulësen e përparme të pasagjerit dhe ka pasur një fëmijë nën moshën 12 vjeçe në ulësen e përparme e kjo sanksionohet me Ligjin mbi Trafikun Rrugor. Ndryshimin e tillë të tiketës nuk e ka pa ose e njejtja nuk i është ofruar në shiqim. Paraprakisht ka biseduar me kolegun E. i cili e ka njoftuar verbalisht se personin që është gjobitë përkatësisht kundërvajtësin konkret e njejt sepse e ka bashkëfshatarë dhe se me të njëjtin nuk e lidh asgjë familjarisht por e din se i njëjti gjendjen ekonomike e ka shumë të rëndë dhe se i njejt merret me grumbullimin dhe shitjen e hekurit të vjetër, dhe nga ai ka kërkuar se a ka ndonjë mundësi ligjore që t'i ndihmohet këtij individ për këto arsye. Përgjigja e këtij dëshmitari ka qenë se sa i përketë anës tij, ai nuk mundet me ndiku në përmirësimin e asaj gjobe, pasi që të njëjtën e ka dorëzuar dhe ajo shkon tek personat tjerë kompetent. Atij nuk i kujtohet që E. i ketë thënë se e ka ndërmend të ndikoj në atë tiketë, përveç asaj që tha më herët.

Në pyetjet e mbrojtësit të të akuzuarit në fjalë edhe atë av. Sevdail Robelli dëshmitari është përgjigjur : kur ka biseduar me E. siç e ka cekur më herët kjo është bërë para se ai mu njoftu nga eprori i tij mirëpo se kur E. ka intervenu në këtë tiketë nuk mund të deklarohet.

Në pyetjen se ju si dëshmitar në rastin e bisedës së E. me juve, E. a ka kërku që ta bëni përmirësimin duke ju lutur juve apo ka kërku një mundësi ligjore që disi t'i ndihmohet një personi të varfër, dëshmitari është përgjigjur: sipas bisedës që e ka zhvillu me kolegun e tij E. ma shumë i njëjti ka kërkuar këshilla nga ai, se si mund t'i bëhet një ndihmë këtij personi të varfër, kurse atij ky dëshmitar i ka thënë që të kërkoj nga instancat tjera një ndihmë të tillë duke mbetur pranë përgjigjes që e ka thënë më herët .

Prokurori i shtetit ka deklaruar se nuk ka vërejtje në dëshminë e këtij dëshmitari, ndërsa mbrojtësi i të akuzuarit dhe i akuzuari kanë pasur vërejtje në kuptim të mbrojtjes.

b) Deklarata e dëshmitarit A. I i cili nuk është në farefisni me të akuzuarin ka deklaruar lidhur me çështjen penale lëndore si në vijim:

Në pytjen e prokurorit të shtetit dëshmitari është përgjigjur se mbetet pranë deklaratës të cilën e ka dhënë në prokurori edhe atë pa ndryshime dhe plotësime. Të akuzuarin E. e ka vendas sepse me të njëjtin jeton në të njëjtin fshat por siç ka thënë më herët me të njëjtin nuk është në farefisni.

Në pytjen e prokurorit të shtetit se a është e vërtetë se me dt.8.01.2018 keni kryer një kundërvajtje në komunikacion në Gjilan, dëshmitari është përgjigjur po, vepra ka qenë ashtu meqë në kamionet e ka pasur djalin e vogël të ulur në vendin e pasagjerit edhe atë të moshës 4 vjeçe dhe e ka pas me veti edhe kusheririn e tij H. L i cili e ka pas para këmbëve të tij të njëjtin duke e mbajtur me duartë e tij. Pasandej e kanë ndal policia te rrethi afër FSK në Gjilan dhe ia kanë shkruar një tiketë dhe gjoba ka qenë 160 euro në atë tiketë dhe i është konfiskuar edhe patent shoferi. Në ato qaste shumë e ka lut policin që mos t'ia merr lejen sepse me atë kamionet ka mbet gjallë sepse punon lidhur me riciklimin e mbeturinave të hekurit dhe llojeve tjera të metalit. Pastaj ka shkuar pesë ditë rresht te ia akuzuari E. dhe të njëjtin e ka lut që t'i ndihmoj rreth kthimit të patent shoferit dhe ai (i akuzuari) nuk i ka premtu kurgja që do t'ia sjell patentin e shoferit apo jo dhe pas një jave ia ka dorëzuar patent shoferin dhe gjobën në emër të tij e kishte pas paguar E. në vlerë prej 10 Euro dhe E. e ka bashkëfshatar kështu që ai e din se në çfarë kushte të rënda jeton, e njeh edhe familjen e tij dhe se nga familja e tij i ka 7 anëtarë të familjes të vrarë nga forcat serbe gjat luftës. Nga emocionet shpirtërore për shkak të humbjes së anëtarëve të familjes dëshmitari ka filluar edhe të qaj e në pytjen e kryetarit të trupit gjykues se a mundet me vazhdu me dëshminë e tij, i njëjti ka deklaruar se pas një kohe të shkurtër pasi të qetësohet do të vazhdoj që të dëshmoj.

Në përgjigjen e dëshmitarit i njëjti deklaron se 10 euro që i kishte paguar E. në emër të tij për kundërvajtjen në fjalë, pasi që e ka lutur shumë dhe e ka shti në be, të njëjtit ia ka dhënë 10 Euro në emër të pagesës. E.i ka thënë, se me rëndësi është që patent shoferin e ki për me vazhdu me punu, kurse spjegime tjera nuk i ka dhënë . Më tutje dëshmitari ka deklaruar edhe këtë se e ndien shumë veten keq që Erduanin e ka ngushtu edhe të njëjtin as që po mundet me kshyrë drejt në sy, sepse ai për shkak të tij tani është në këtë sallë (të gjykimit). Shumë e ka lut E. i ndihmojë për t'ia kthyer patent shoferin, dhe se të njëjtit nuk i ka premtu se do ta shpërblej nëse i ndihmon, por as ai nuk i ka kërkuar kurfarë shpërblimi sepse mendon se ai e ka ditë gjendjen e tij të rëndë ekonomike, meqë kanë jetuar në të njëjtin fshat.

Në pytjen e mbrojtësit dëshmitari përgjigjet se familjes tij, pra duke e përfshirë edhe dëshmitarin në fjalë për shkak që kanë pas rastin për humbjen e 7 anëtarëve të familjes dhe gjendjes ekonomike të rëndë i ndihmojnë e gjithë fshati.

Në pytjen intervenuese të kryetarit të trupit gjykues dëshmitari përgjigjet se në familjen e tij ka shtatë anëtarë dhe se familjen e tij e mbanë duke grumbulluar mbeturina të hekurit dhe ndihmën që jua ofrojnë fshatarët, pra burime tjera për ekzistencë nuk ka. Po ashtu posaçrisht dëshmitari ka thënë se vëllau i E. dhe baba i tij i kanë ndihmu materialisht por edhe i kanë ofru punë tue ia paguar shërbimet për punë që i ka ba.

Prokurori i shtetit, mbrojtësi i të akuzuarit dhe i akuzuari nuk kanë vërejtje në dëshminë e dëshmitarit.

5. Provat materiale

a) Sipas të dhënave në fletparaqitjen për kundërvajtje në trafik të datës 08.01.2018 me numër 2593386 rezulton se zyrtarët policor S. D me DI nr. 2578 dhe B. O me DI nr 7048 kundërvajtësit A.H i kanë shqiptuar dënim me gjobë prej 160 Euro, për kundërvajtjen nga neni 188 paragrafi 6 të Ligjit për rregullat e trafikut rrugor nr. 05/L-88, për shkak se ka pas gjatë vozitjes në trafik publik fëmijën nën moshën 12 vjeçe në kabinën e Kamionetës, por edhe masën mbrojtëse prej 3-6 muaj.

b) Sipas fletparaqitjes për kundërvajtje me numër dhe datë të lartcekur rezulton se neni 188 është përmirësuar me laps kimik me dorë të lirë duke u shënuar në vend të nenit 188 neni 118, kurse pjesa tjetër e shënimeve nuk është prekur, pra as dënimi i shqiptuar, as ngjarja kundërvajtëse e përshkruar por as shënimet tjera në fletëparaqitje, por që neni 118 i ndryshuar nuk përputhet me ngjarjen lëndore kundërvajtëse.

c) Sipas fletpagesës së datës 16.01.2018 rezulton se kundërvajtësi A. I ka paguar 10 Euro plus një euro për shërbim të Institucionit financiar Unioni Financiar Prishtinë në emër të dënimit kundërvajtës të datës 08.01.2018 Policisë së Kosovës sipas tiketës nr. 2583386.

Sipas Raporteve të oficerve policor edhe atë të oficerit Naser Rrahmanit me numër të DI 4065, B.O dhe S. D të datës 29.01.2018 rezulton :

-në raportin e oficerit të parë është shënuar se në lidhje me tiketën me numër 2583386 të shqiptuar në emër të kundërvajtësit A.H nga zyrtari policor S. D më datën 08.01.2018 është njoftuar për përmirësimin e tiketës, se ka biseduar me zyrtarin që punon në arkiv E. B dhe i njëjti e ka njoftuar se e ka bërë përmirësimin në pajtim me zyrtarët policor që e kanë shkruar tiketën. Realisht gabime ka pas pasi që në raportet e aksidentit që nuk vërehet mirë kopja pastaj shkrimi jo i qart sepse disa shkruajnë bukur e disa mezi mund t'i kuptosh çka kanë shkruar apo nuk mund t'i lexosh gerमत, e gabime tjera kanë ndodh në vazhdimësi por janë përmirësuar nga vetë zyrtarët që i kanë shkruar raportet, kanë shkruar raporte policore lidhur me këtë dhe i kanë nënshkruar të njëjtit dhe se nuk ka pasur asnjëherë telashe. Ky raport është shkruar me kërkesë të Inspektoratit Policor të Kosovës.

-në raportin policor të zyrtarit policor S. D është shënuar se si gjatë realizimit të pikës së kontrollit ka hasur në një automjet transportues - kamionet në kabinën e të cilit ishte një fëmijë nën moshën 12 vjeçe dhe vozitësit i është shqiptuar një tiketë sipas ligjit të trafikut. Pas disa dite është kontaktuar nga kolegu E.B, i cili e ka pyetur se a mundet t'i ndimohet palës që i është shqiptuar tiketa, pasi që i njëjti e ka gjendjen ekonomike të rëndë dhe i njëjti e mban familjen duke mbledhur hekura të vjetër. E. e ka pyetur se a ka mundësi t'i ndihmohet disi, kurse oficeri policor S.D i ka thënë “ nëse ekziston mundësia që t'i ndohmohet në personalisht nuk kam asgjë kundër”. Për këtë bisedë e ka njoftuar edhe kolegun respektivisht partnerin me të cilin ka qenë ditën kur është shqiptuar tiketa, ku edhe ai nuk ka shfaq ndonjë kundërshtim, pasi që tiketa ishte në emër timin (të S.D).

-në raportin e oficerit policor B. O të datës 29.01.2018 ndër të tjera është shënuar sikurse në raportin e oficerit S.D por edhe ky tekst si në vijim : pas disa ditëve nga zyrtari i administratës policor E. B është kontaktuar z.policor S. D ku ai ka kërkuar që të bëhej një përmirësim në nenin përkatës. Për këtë unë jam njoftuar nga ana e policit S. D përmes telefonit, i cili ka kërkuar mendimin tim për këtë rast meqë unë isha polici i dytë në atë tiketë. Unë i jam përgjigjur, që mua nuk më prish ndonjë punë nëse ndryshohet ky nen përderisa ekzistojnë mundësit. Kjo është e tëra që ka të bëjë me këtë rast.

6. Dispozitat ligjore kundërvajtëse

Sipas nenit 188 të Ligjit nr. 05/L-088 për Rregullat e Trafikut Rrugor “ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 32/5 shtator 2016, Prishtinë “parashihet :

Paragrafi 1. Fëmijët nën moshën 12 vjeçe dhe me lartësi nën 150 cm të cilët transportohen në mjetet nga neni 187 të këtij ligji kanë të instaluar rripa të sigurisë, **duhet** të jenë të siguruar tërësisht apo pjesërisht me sistem të sigurt d.m.th. me ulëse të sigurisë për fëmijë, të përshtatur për masën dhe lartësinë e fëmijëve.

Paragrafi 3. Në mjetet nga paragrafi 1. të këtij neni nuk lejohet të ulen në ulëset e para fëmijë nga tre e më shumë vjeç dhe me lartësi nën 150 cm.

Paragrafi 6 – Dënohet për kundërvajtje me gjobë prej **100 – 300 Euro**, shoferi i mjetit i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni. Atij i shqiptohet edhe masa mbrojtëse **ndalim i të drejtuarit të mjetit me veprim motorik në kohëzgjatje prej tre deri në gjashtë muaj.**

Vlen të theksohet se vet dëshmitari A. H në deklaratën e tij ka theksuar se ka pas në kamionet fëmijën e moshës 4 vjeçe. E nga fletëparaqitja kundërvajtëse në trafik me numër dhe datë të lartcekur rezultoi se dëshmitari S. D si oficer policor formularin e saj e ka plotësuar dhe nënshkruar së bashku me kolegun e tij si oficer policor, duke shqiptuar dënimin kundërvajtës prej në shumën prej 160 Euro plus masën mbrojtëse prej 3-6 muaj.

Sipas nenit 118 të këtij ligji sanksionohet kundërvajtja lidhur me **dritat e pozicionit** edhe atë me gjobë prej 20 Euro, e nga prova e lartcekur rezultoi se 50% të këtij dënimi në emër të dëshmitarit A. ka paguar i akuzuari në fjalë.

Vlen të theksohet se dispozita nga neni 118 të ligjit në fjalë **as që ka të bëjë me ngjarjen kundërvajtëse të kundërvajtësit A. I**, tani dëshmitar.

7. Vlerësimi i provave

7.1.Faktet jo kontestuese :

-nuk është kontestuese se i akuzuari në fjalë ka përmirësuar personalisht fletëparaqitjen për kundërvajtje në trafik me numër 2583386 të datës 08.01 2018 duke shënuar me dorë të lirë në vend të **nenit 188 numrin 118** të Ligjit mbi rregullat e trafikut rrugor, kurse shënimet e tjera kanë mbetur ashtu siç kanë qenë, e këtë e ka pranuar personalisht i akuzuari në fjalë,

-pastaj se nuk është kontestuese se para se me përmirësuar tiketën –fletëparaqitjen lëndore në emër të kundërvajtësit A. H i akuzuari ka biseduar me zyrtarin policor S. D. tani dëshmitar lidhur me mundësinë e përmirësimit të kësaj tikete, për shkak të gjendjes së rëndë ekonomike të bashkëfshatarit të të akuzuarit A. H tani dëshmitar, i cili mban familjen me kamionetën e tij duke grumbulluar hekura të vjetër,

-por edhe fakti se i akuzuari përmirësimin e tillë të tiketës e ka bërë për shkak të gjendjes së rëndë ekonomike të A. H meqë të njëjtin e ka bashkëfshatar.

-nuk është kontestuese që dëshmitari A. H ditën kritike e ka pasur të ulur fëmijën 4 vjeç në ulësen e përparme të kamionetës edhe pse e ka ditur se një veprim i tillë është i ndaluar,

-se sipas kërkesës së dëshmitarit A. H i akuzuari pasi që ka paguar 10 Euro për kundërvajtjen e përmirësuar, lejen e qarkullimit për kamionetë dhe fletëpagesën për kundërvajtjen e paguar ia ka dorëzuar dëshmitarit A. H, i cili ia ka paguar shumën prej 10 Euro meqë paraprakisht i akuzuari kishte paguar këtë shumë për kundërvajtjen e përmirësuar.

7.2 Faktet kontestuese :

- i akuzuari E. e ka cilësin e personit zyrtar apo jo,
- i akuzuari a ka pasur autorizim apo jo për ta përmirësuar nenin e shënuar në tiketën lëndore kundërvajtëse për trafik të lëshuar nga zyrtari policor S. D,
- është i mjaftueshëm apo jo miratimi për përmirësimin e tiketës lëndore nga zyrtari policor S. D i cili ka plotësuar tiketën e tillë së bashku me kolegun e tij zyrtarin policor B.O në vend të ngjarjes dhe
- a është i lejuar përmirësimi lëndor i teketës pas dorëzimit të saj tek shërbimi përkatës për realizimin e saj duke mos u ndërlidhur me ngjarjen kundërvajtëse ndaj kundërvajtësit në fjalë,
- a është tiketa lëndore dokument zyrtar

Mbrojtjes së të akuzuarit gjykata nuk ia ka falur besimin pasi që mbrojtja e tij nuk ka mbështetje në asnjë provë as personale e as materiale.

Dëshmitari S. D gjykata ia ka falur besimin meqë i njëjti asnjëherë nuk ka dhënë pëlqimin e as që është dakorduar që në mënyrë antiligjore të përmirësohet tiketa lëndore sa i përket nenit kundërvajtës në trafik të dhënë nga ana e tij, mirëpo është dakorduar që të gjendet ndonjë variantë tjetër për ta ndihmuar kundërvajtësin A. H në procedurë ligjore. Në rastin konkret më tepër i akuzuari E. është këshilluar me dëshmitarin S. të gjendet një modus për ta ndihmuar dëshmitarin A., duke e njoftuar të njëjtin për gjendjen e rëndë ekonomike të tij.

Deklarata e këtij dëshmitari përputhet me provat materiale të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor siç janë fletëparaqitja për kundërvajtje në trafik me numër dhe datë të lartcekur por edhe me fletëpagesën me numër dhe datë të lartcekur sipas të cilës është bërë pagesa 50% e dënimit kundërvajtës sipas nenit të përmirësuar 118 të ligjit për rregullat e trafikut rrugor, dispozitë kjo e cila nuk ka kurrëfarë lidhje me ngjarjen kundërvajtëse për shkak të uljes së fëmijës katër vjeç në kabinën e kamionetës derisa e ka drejtuar kamionetën kundërvajtësi A. në trafik publik, të cilave gjykata jua ka falur besimin e plotë.

Formulari me titullin fletëparaqitje për kundërvajtje në trafik i plotësuar nga zyrtarët policor me autorizim për të shqiptuar gjobat sipas ngjarjes kundërvajtëse së bashku me masat mbrojtëse, e në këtë rast sipas nenit 188 paragrafi 6 të Ligjit për rregullat e trafikut publik – **është dokument zyrtar**, sepse të njëjtin e ka plotësuar personi zyrtar policor S. D gjatë ushtrimit të autorizimeve zyrtare policore gjatë kohës së punës së tij me kolegun e tij B. O, me të dhëna lidhur me kundërvajtjen përkatëse me nen përkatës të ligjit përkatës, me gjobë të shqiptuar së bashku me masën mbrojtëse prej 3-6 muaj, me shënimin e emrave të këtyre personave zyrtar policor së bashku me numrin e dokumenteve të identifikimit zyrtar të tyre, datë, muaj dhe vit por edhe me numër të tiketës, duke përfshirë edhe shenimet personale të kundërvajtësit por edhe përshkrimin faktik të kundërvajtjes së përshkruar më lartë. Një konstatim i tillë rezulton edhe nga përshkrimi i dispozitës nga neni 434 paragrafi 1 lidhur me falsifikimin e dokumentit zyrtar edhe atë : **Personi zyrtar i cili në dokumentin zyrtar, në regjistër ose në shkresën zyrtare shënon të dhëna të rreme ose nuk shënon të dhënat e duhura apo me nënshkrimin e tij ose me vulën zyrtare vërteton dokumentin zyrtar, regjistrimin apo shkresën zyrtare e cila përmban të dhëna të rreme ose mundëson përpilimin e dokumentit, regjistrin ose shkresës së tillë me përmbajtje të rreme, dënohet me burgim prej 6 muaj deri në 5 vjet.**

Sipas nenit 120 me titull Domethëniet e shprehjeve në Kodin Penal edhe atë paragrafi 1 nënparagrafi 8 të KPRK-s me fjalën “ dokument “ kuptojmë çdo dokument apo send tjetër të përshtatshëm ose i caktuar që shërben si provë e ndonjë fakti përkatës për marrëdhëniet juridike. Në rastin konkret fletëparaqitja kundërvajtëse në trafik me numër dhe datë të lartcekur paraqet **dokument zyrtar me formë të urdhrin kundërvajtës (sipas nenit 30 paragrafi 4 të Ligjit për kundërvajtje)** të oficerve policor në fjalë me të

cilin kundërvajtësi A. I është shpallur përgjegjës për kundërvajtjen nga neni 188 paragrafi 6 të Ligjit për rregullat e trafikut rrugor duke ju shqiptuar dënimi kundërvajtës prej 160 Euro dhe masa mbrojtëse prej 3-6 muaj.

Në rastin konkret pasi që është shqiptuar gjoba për kundërvajtjen lëndore sipas ngjarjes kundërvajtëse të përshkruar në tiketë nga ana e zyrtarëve policor të cekur më lart dhe tiketa është dorëzuar për realizim më tutje së bashku me marrjen e patent shoferit nga kundërvajtësi A. H, të njëjtën nuk ka pas autorizim askush që ta ndryshoj (përmirësoj), përveç të ndonjë gabimi teknik eventual ose nëse kopja e tiketës ka pas shkrim të palexueshëm në tekstin dhe numrat e saj, por këto gabime teknike dhe kjoartësimi i përshkrimeve të cakura më lart mund t'i bëjnë vetëm personat zyrtar policor që e kanë dhënë tiketën e tillë – fletëparaqitjen e tillë, e jo personat e tjerë zyrtar pa marrë parasysh pozitën e tyre funksionale.

Gabimet e hapta pa tjetër duhet përmirësuar, por sa i përket ndërrimit të të dhënave si në rastin konkret nga neni 188 në nenin 118 në tiketën lëndore si shkresë – dokument zyrtar këtë autorizim nuk e ka askush e as i akuzuari në fjalë, sepse i njëjti hynë në zonën penale për falsifikim të dokumentit zyrtar ose të keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar ose të ndonjë veprë tjetër penale, por në rastin konkret në vepër penale të falsifikimit të dokumentit zyrtar nga neni 434 paragrafi 1. të KPRK-s.

Sa i përket përmbajtjes së raporteve të oficerëve policor të datës 29.01 2018 të dhëna nga zyrtarët policor S. D dhe B. O të cilët kanë shqiptuar tiketën lëndore ndaj kundërvajtësit A. H, gjykata i ka vlerësuar këto raporte duke përfshirë edhe raportin e oficerit N. R me theks të veçantë se dëshmitari **S. D** si oficer policor i është përgjigjur të akuzuarit lidhur me atë që t'i ndihmohet kundërvajtësit në fjalë me fjalët “ **nëse ekziston mundësia që t'i ndihmohet unë personalisht nuk kam asgjë kundër**” pastaj se për këtë bisedë e ka njoftuar edhe kolegun me të cilin ka qenë ditën kur është shqiptuar tiketa, ku edhe ai nuk ka shfaq ndonjë kundërshtim pasi që tiketa ishte në emër të tij (dëshmitari ka menduar në atë që tiketën lëndore e ka lëshuar ai personalisht por e ka nënshkruar edhe kolegu i tij B.O). Pastaj oficeri policor në raportin e tij ndër të tjera ka theksuar lidhur me përmirësimin e nenin përkatës, edhe atë duke theksuar “ **për këtë unë jam njoftuar nga ana e policit S. D përmes telefonit, i cili e ka kërkuar mendimin tim për këtë rast, pasi që unë isha polici i dytë në atë tiketë. Unë i jam përgjigjur që mua nuk më prish ndonjë punë nëse ndryshohet ky nen përderisa ekzistojnë mundësit**”.

Gjykata ka ardhur në përfundim se i akuzuari E. nuk ka pasur autorizim për ta përmirësuar nenin e tiketës, edhe po të ishin të pajtimit për një veprim të tillë oficerët policor të lartcekur, meqë i njëjti nuk e ka plotësuar formularin e tillë për kundërvajtjen lëndore. Këtë të drejtë si autor zyrtarë policor e kanë pasur vetëm dëshmitari S. D por edhe zyrtari tjetër policor B. O, por jo për t'i dhënë favore kundërvajtësit, e në rastin konkret dëshmitarit A. I, por vetëm në rast se eventualisht në flatëparaqitje është bërë ndonjë gabim teknik ose nëse eventualisht shkrimi në fletëparaqitje është i palexueshëm, duke u pamundësuar veprimi sipas atij akti shkresor – urdhri kundërvajtës.

Nga provat e lartcekura e të elaboruara më lart rezulton se i akuzuari E. ka qenë i vetëdijshëm se përkundër pëlqimit të dhënë nga dëshmitari S.D që të gjendet ndonjë mundësi për t'i ndihmuar kundërvajtësit A. në procedurë ligjore, për shkak të gjendjes së rëndë ekonomike, ka vendos që të bëjë përmirësimin e nenit të kundërvajtjes me dorë të lirë edhe atë mbi numrin 188 ka shenuar numrin 118, e kundërvajtja nga neni 118 as që ka pas të bëjë me ngjarjen kundërvajtëse lëndore por me dënim me gjobë më të vogël në masë të madhe sepse me nenin 188 paragrafi 6 është paraparë dënimi me gjobë prej 100-300 Euro me masë mbrojtëse me

marrjen e lejes së vozitjes kurse me nenin e përmirësuar dënimi ka qenë deri në 20 Euro, duke qenë në lajthim të shmangshëm meqë si oficer policor ka qenë në dijeni se po hynë në zonë penale dhe me këtë pasojë është pajtuar, pra ka vepruar me dashje eventuale, i shtyer nga emocionet për shkak të gjendjes së rëndë ekonomike të bashkëfshatarit të tij A. H duke qenë në dijeni se i njëjti ka humbur gjatë luftës në Kosovë 7 anëtarë të familjes dhe se me kamionetën e tij mban familjen e tij duke grumbulluar mbeturina të hekurit. Përkundër kësaj veprimi konkret i të akuzuarit është i kundërligjshëm meqë si person zyrtar e ka kuptuar rëndësinë e veprimit të tillë dhe se ka qenë i detyruar që t'i kontrolloj sjelljet e tij duke u përmbajtur ng një veprim i tillë i cili edhe hynë në zonë penale përkundër asaj që vetes nuk i ka sjell ndonjë dobi materiale apo me natyrë tjetër. Rrethana se një veprim të tillë i akuzuari e ka ndërmarr për shkak të gjendjes së rëndë ekonomike të dëshmitarit A. H, të cilin i akuzuari e ka bashkëfshatar, nuk e liron nga përgjegjësia penale të akuzuarin, meqë kjo rrethanë eventualisht mund të merret vetëm si rrethanë lehtësuese me rastin e përcaktimit të gjykatës për llojin dhe lartësinë e dënimit. Pra, nuk mund të përdoret si rrethanë që e përjashton përgjegjësinë penale të të akuzuarit në fjalë.

Duke pasur parasysh këtë gjendje faktike gjykata ka vërtetuar se i akuzuari E. ka kryer veprën penale falsifimi i dokumentit zyrtar nga neni 434 paragrafi 1 të KPRK-s, dhe të njëjtin e ka shpall fajtor duke i shqiptuar dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

8. Rrethanat lehtësuese dhe rënduese

Me rastin e përcaktimit për llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka vërtetuar këto rrethana lehtësuese edhe atë : se i akuzuari për herë të parë është ndeshur me ligjin, se më parë asnjëherë nuk ka qenë i dënuar për ndonjë vepër penale bile as për ndonjë vepër disiplinore gjatë punës në Polici të Kosovës, se ndaj tij nuk zhvillohet kurrëfarë procedure penale por as disiplinore në Polici të Kosovës, se i akuzuari ka përmirësuar tiketën lëndore pr shkak të gjendjes së rëndë të dëshmitarit A. H të cilin e ka bashkëfshatar dhe mban familjen e tij përmes grumbullimit të mbeturionave të hekurit të cilat i bartë me kamionetë dhe dhimbjes së arsyeshme të shprehur nga i akuzuari ndaj dëshmitarit A., e ky i fundit gjatë luftës së fundit në Kosovë ka humbur shtatë anëtarë të familjes dhe se ende nuk është rehabilituar nga traumat e tilla të përjetuara, ndërsa rrethana rënduese nuk ka gjetur.

Gjykata duke pasur parasysh gjendjen faktike të vërtetuar por edhe rrethanat e lartcekura në kuptim të nenit 75 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 të KPRK-s të akuzuarit ia ka shqiptuar në minimumin e veçantë të paraparë për veprën penale lëndore në kohëzgjatje prej gjashtë muajve përkatësisht prej 180 ditëve, e me pëlqimin shprehimisht të dhënë nga i akuzuari pas shpalljes së aktgjykimit, dënimin me burgim në kuptim të nenit 47 të KPRK-s ia ka yvendësuar me dënim me gjobë në shumën prej 1,200.00 Euro, me bindje të plotë se edhe me një dënim të tillë në kuptim të nenit 41 të KPRK-s mund të arrihet qëllimi i plotë i dënimit si tek i akuzuari në fjalë duke e rehabilituar të njëjtin – duke shtuar kujdesin në të ardhmen tek i njëjti gjatë ushtrimit të detyrave zyrtare policore, por edhe tek qytetarët potencial sidomos tek personat zyrtar që në të ardhmen mos të kryejnë vepra të tilla penale apo të ngjashme, duke ngritur moralin dhe forcuar detyrimin që të respektojnë dispozitat ligjore penale duke mos rrezikuar e as dëmtuar të mirat juridike të mbrojtura me dispozita pozitive penale.

Mirëpo, nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj dënimin me gjobë, atëherë në kuptim të nenit 46 paragrafi 3 të KPRK-s, me vet faktin që është **suspenduar dënimi me burgim**, janë krijuar kushtet ligjore që këtij të akuzuari t'i zëvendësohet dënimi me gjobë me atë me burgim, duke ju llogaritur çdo 20 Euro nga një ditë burgim. Gjykata e shkallës parë këtë përfundim e ka nxjerr nga praktika gjyqësore e krijuar nga Gjykata Supreme e Kosovës, duke u

bazuar në aktgjykimin e kësaj gjykate Pml.nr. 259/2019 të datës 05. Shtator 2020. Sipas këtij aktgjykimi në arsyetimin e tij në faqen 4 pasuesi i dytë thuhet: “ ... **meqë në momentin e zëvendësimit të dënimit me burgim me dënim me gjobë, dënimi me burgim suspendohet dhe hynë në fuqi dënimi me gjobë (si titull ekzekutiv), kurse në rast të mospërmbushjes së pagesës së gjobës duhet të aplikohen dispozitat e dënimit me gjobë siç ëdhtë përcaktuar në nenin 46 paragrafi 3 të KPRK-s, sipas të cilës dispozitë parashihet se dënimi me gjobë (me aktgjykimin lëndor trajtohet si dënim aktual me titull ekzekutiv) zëvendësohet me dënim me buergim duke u llogaritur çdo 20 Euro me nga një ditë burgim, përkatëisht në rastin konkret në kohëzgjatje prej gjashtëdhjetë ditëve.**

Në rastin konkret dënimi me gjobë i zëvendësuar me atë me burgim është disa fish më pak se tri vite.

Në kuptim të nenit 368 të KPP-s i akuzuari është njoftuar me të drejtën në ankesë kundër aktgjykimit dhe se dhënia e pëlqimit për zëvendësimin e dënimit me burgim me atë me gjobë nuk e privon të akuzuarin nga e drejta ligjore për të ushtruar ankesë kundër këtij aktgjykimi.

9. Shpenzimet e procedurës penale, paushalli gjyqësor si dhe taksa për kompensimin e viktimave të krimit

Gjykata lidhur me shpenzimet e procedurës penale përkitazi me paushallin gjyqësor vendosi në kuptim të nenit 450 lidhur me nenin 453 të KPP. Kurse për taksën për kompensimin e viktimave të krimit sipas nenit 39 paragrafi 3 nënparagrafi 3.2 të Ligjit për kompensimin e viktimave të krimit “Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 17/30 Qershor të vitit 2015, Prishtinë”.

Nga të cekurat e më lartë, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN- Departamenti i Krimeve të Rënda PKR.nr. 32/2020, më dt. 18 shtator të vitit 2020

Sekretarja juridike,
Kadrije Zymberi,

Kryetari i trupit gjykues,
Aziz Shaqiri, d.v.

Udhëzim për mjetin juridik:

Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë – Departamenti i krimeve të rënda, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit.

Ankesa në kopje të mjaftueshme dorëzohet përmes kësaj Gjykate.

Numri i lëndës: 2018:007050
Datë: 06.10.2020
Numri i dokumentit: 01166402